

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

KM-MIT-01
 2

Mr. I Prot. Broj Prot. 316/19
 Pril. No. 13.05.19
 Data: 13.05.19
 Datum: 13.05.19

PRISHTINË/A



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit 01
 Nr. i Faqeve Be. Stranica No. Pages 2

Hr. I Prot. Broj Prot. 4976
 Prot. No. 4976
 Data: 13.05.19
 Datum: 13.05.19

PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa nr.2375 të datës 07.03.2019 parashtruar nga operatori i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus N.T. "EGNATIA" me seli në Kmetoc-Kamenicë, kundër vendimit nr.1643 të datës 21.02.2019 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.1750 të datës 22.02.2019 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisjes në relacionin Gjilan - Ferizaj dhe ansajelltas me kohë të nisjes 06:40 - 09:00.

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.2259 datë 06.03.2019 pas shqyrtimit të ankesave, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht nenin 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë rrjetin aktual të linjave ndër-urbane, konstaton se nisja e shpallur në relacionin Gjilan - Ferizaj (06:40 - 09:00) nuk pengon në nisjet aktuale të vërtetuara nga MIT-ja në këtë relacion pasi që koha minimale e operimit ndërmjet linjave/nisjeve aktuale në këtë relacion është njëzetetë (20) minuta, kështu që nisja (me orarë: 06:40 - 09:00) të shpallur në relacionin e lartëcekur ka një diferencë kohore

të operimit në kuadër të limitit të lartecukur përkatësisht është në harmoni me kohën aktuale të operimit ndermjet linjave njëzet (20) minuta.

Andaj duke pasë parasysh të cekurat më lartë dhe duke iu referuar legjislacionit në fuqi Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka vlerësuar të domosdoshme shtimin e numrit të nisjeve të reja në mënyrë që të kemi shërbime të mjaftueshme për udhëtarët që frekuentojnë në këtë relacion duke krijuar një treg liberal me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e mundësisve më të mëdha për qasje më të shpejtë dhe më lehtë për qytetarët që shfrytëzojnë shërbimet e transportit me autobus.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

